



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR**  
KANCELARIJA DISIPLINSKOG TUZIOCA – OFFICE OF THE DISCIPLINARY COUNSEL

---

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), shpallë,

## KONKURS

### **Praktikant/e Profesionale (pa pagës) 6 gjashtë pozita**

Kandidatët e përzgjedhur do të sistemohen në ZPD dhe do të angazhohen që të mbështesin punën e ZPD-së. Praktikantët do të shërbejnë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për periudhën një (1) vjeçare.

#### **Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Ndhmon në hartimin dhe përgatitjen e raporteve, korrespondencave, memove, formularëve, si edhe mban agjendën e përditshme;
- Ndhmon dhe përkrah të gjithë punonjësit e ZPD-së dhe bashkëpunëtorët në aspektin administrativ: shënimeve, raporteve, punëve juridike,
- Ndhmon në hulumtime kuantitative dhe kualitative dhe i mbledhë/analizon informata duke përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të punëve administrativo-juridike në ZPD;
- Ndhmon në përgatitjen e raporteve rreth punëve juridike;
- Ndhmon në administrimin e korrespondencave, duke përfshirë regjistrimin, klasifikimin dhe shpërndarjen e përshtatshme;
- Ndhmon në kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi brenda fushës së përgjegjësisë.

#### **Kualifikimet e kërkuara:**

- Kandidati/ja duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin Juridik (bachelor ose 4 vjeçar);
- Të ketë njohuri të gjuhës shqipe ose serbe (në shkrim dhe në të folur);
- Të ketë përkushtim dhe interesim për të mësuar;
- Shkathtësi të mira të komunikimit;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter (MS Office );

- Të jete dinamik, fleksibil, kreativ dhe i/e gatshëm për punë në ekip.
- Çdo kualifikim tjetër do të konsiderohet si përparësi.

### **Benifitet nga Praktika Profesionale (pa pagesë)**

- Ofrojmë ambient dinamik dhe miqësor të punës,
- Mundësi për ngritje profesionale nga trajnimet e ndryshme që ofrohen brenda dhe jashtë ZPD-së,

Kandidatët e interesuar, duhet të paraqesin: një letër motivuese (në gjuhën shqipe ose serbe), CV/ Rezyme, certifikatën e notave dhe diplomën.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në Ueb faqe, si dhe në njërën nga gazetatat ditore, duke filluar nga data e publikimit më 14.11.2017 gjer më datën 28.11.2017 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

### [Shkarko Aplikacionin](#)

**Përzgjedhja e kandidateve për praktikant/e do të bëhet bazuar në dokumentacion e ofruar dhe në intervistë.**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni tek Adresa: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës/ Zyra e Pranimit, Rruga « Luan Haradinaj » nr.133 (ish ndërtesa e Gjykatës supreme), Prishtinë, Kosovë;

Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtaren e personelit në numrin e telefonit: 038-200-17-144

*Do të kontaktohen vetëm kandidatet që plotësojnë kriteret e cekura më lartë.*